



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:242621

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05476570

E.nr.0123/2011

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit individual Hajrullah Aruqi me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekomi i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit U.L., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 252.55 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore e kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekomi i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj U.L., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 252.55 euro (dyqind e pesëdhjetë e dy euro e pesëdhjetë e pesë cent).

A r s y e t i m

Gjykata me Aktvendimin E.nr.0123/2011 me dt.27.06.2011 e ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A.-Vala me seli në Prishtinë, U.L., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 252.55 euro.

Debitori e ka njoftuar gjykatën se e ka përmbushur borxhin në tërsi, kjo dëshmohet përmes dëftesave të lëshuara nga Telekomi i Kosovës nr.73181497 e dt.15.03.2024 e cila është në shumën prej 252.55 euro, si dhe taksën gjyqësore në shumën prej 15 euro me numër të pagesës 19244945-2024-Skenderaj, e lëshuar nga Posta e Kosovës dt.15.03.2024.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 par.4 të LPP-së, në të cilin është përcaktuar se “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedurës përmbartimore”, andaj nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
E.nr.0123/2011, me dt.20.03.2024

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.